

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "V.A.S Konstruksion" Shpk është regjistruar pranë Qendres Kombetare të Biznesit me date 22.01.2016. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" me NIPT L61322023P

Kapitali themeltar i shoqërisë "V.A.S Konstruksion" Shpk është 1,000,000 Lekë, i ndarë në 1 kuotë.

"V.A.S Konstruksion" sh.p.k është një shoqëri shqiptare me ortak të vetëm z. Muhamet Petriti zotërues i 100 % I kuotës së kapitalit të Shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë është z. Nestor Muhametllari.

Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga " Andon Zako Çajupi", Qendra Zayed Bussiness Center, seksioni 3 C, D, kati III-të .

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie ka të bëjë me veprimtarinë në fushën e ndertimit të përgjithshëm; veprimtari në fushën e projektimit dhe zbatimit; veprimtari në fushën e ujësjellës – kanalizimeve; supervizionit dhe ndertimin e linjave elektrike mbitokesore dhe nentokesore për energji elektrike dhe telekomunikacioni dhe tensioni të mesëm (kabinat elektrike).

1. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

1.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

1.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

1.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.



1.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

1.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5 Vlerësim dhe gjykime (vazhdim)

aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

1.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

1.5.2. Provizionet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.



1.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

2. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

2.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2020	2019
EUR/LEK	123.70	121.77
USD/LEK	100.84	108.64

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të

ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare ç'regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbañen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të



përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

ii. Kostot e mëpasshme


Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i

pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:



 7

Kategoria e aktiveve	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Toka	Nuk amortizohet	0 %
Ndërtime dhe instalime	Vlerë e mbetur	5 %
Makineri e paisje	Vlerë e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlerë e mbetur	20 %
Paisje kompjuterike	Vlerë e mbetur	25 %
Mobilje e orendi	Vlerë e mbetur	20 %
Të tjera	Vlerë e mbetur	20 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.6 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit, që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare, të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.7 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit



për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15%, (2020: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në bankë	60,009,690	7,278,747
Llogari rrjedhëse		
Mjete monetare në arkë	1,907,947	7,575,937
	<u>61,917,637</u>	<u>14,854,684</u>

5. Llogaritë e arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Klientë	229,630,722	177,606,726
	<u>229,630,722</u>	<u>177,606,726</u>

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Detyrime doganore	5,048	780
Të tjera kërkesa të arkëtueshme	306,988	111,099
	<u>312,036</u>	<u>111,879</u>



7. Inventari

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Materiale te para	5,944,548	1,247,228
	5,944,548	1,247,228

8. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Shpenzime të periudhave të ardhshme	20,671,158	49,200
Parapagime	4,098,052	0
	24,769,210	49,200



9. Aktive afatgjata materiale

Emertimi i Aktiv te Qendrueshme	Filltare	Amortizim i i		Shtesa 2020	Daj e 2020	Amortizim i i		
		Vlera e mbetur deri 31.12.2019	Vlera e mbetur deri 31.12.2019			Vlera e mbetur deri 31.12.2020	Akumuluar deri 31.12.2020	
Instalime teknike, makineri, pajisje, instrumente dhe vegla pune	2,943,703	404,869	2,364,939	173,895	0	646,936	1,891,898	1,051,805
	14,106,58			7,101,37			10,681,92	
Mjete transporti	1	2,204,510	4,800,694	7	0	1,220,150	1	3,424,660
Mobilje e orendi	1,576,083	206,336	658,010	711,736	0	142,761	1,226,986	349,097
Pajisje Inf. kompjuterike	1,069,077	349,631	459,719	259,727	0	120,919	598,528	470,550
Koncensione dhe të drejta të ngjashme, license	701,812	105,272	596,540	0	0	89,481	507,059	194,753
Totali	20,397,256	3,270,618	8,879,902	8,246,736	0	2,220,246	14,906,392	5,490,864



10.Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Furnitore	175,654,993	117,722,801
	<u>175,654,993</u>	<u>117,722,801</u>

11.Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	407,427	238,809
Tatimi mbi të ardhurat nga Punësimi	47,938	
Tatim mbi fitimin	8,098,980	11,717,810
Tatim në burim	0	8,636
TVSH për t'u paguar	290,553	128,810
	<u>8,844,898</u>	<u>12,094,065</u>

12.Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Te pagueshme ndaj punonjesve	1,690,461	838,426
Te pagueshme ndaj ortakeve	6,505,177	
	<u>8,195,638</u>	<u>838,426</u>

13.Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurter për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Qera Financiare-Leasing	123,767	0
	<u>123,767</u>	<u>0</u>



14.Kapitali

Më 31 dhjetor 2020 kapitali i regjistruar i shoqërisë është 1,000,000 Lekë (2019: 100Lekë), i ndarë në 1 kuotë me vlere nominale 1,000,000 Lekë.

	31 dhjetor 2020				31 dhjetor 2019		
	Kuotat	Vlera nominale	Në %		Kuotat	Vlera nominale	Në %
Muhamet Petriti	1	1,000,000	100%	Muhamet Petriti	1	100	100%
	1	1,000,000	100%		1	100	100%

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Kapitali i nenshkuar	1,000,000	100
Rezerva ligjore	3,604,711	
Fitimi/(humbja) e pashperndare	33,244,858	
Fitimi/(humbja) e periudhes	106,811,679	72,094,227
	144,661,248	72,094,327

15.Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga punime ndërtimi për të tretë	419,750,196	306,698,184
Të ardhura nga punime per vete	117,990	
Të ardhura nga shitja e materialeve	31,680	
	419,899,866	306,698,184



Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së:

Të ardhurat e deklaruara në FDP e shoqërisë ndryshojnë nga të ardhurat e pasqyruara në PASH.
 Ndryshimet lidhen me:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Shitje total te deklaruara ne FDP TVSH	419,899,866
Shitje te dekalruar ne FDP qe jane te ardhura ne PASH	419,899,866
Të ardhura nga punime ndërtimi për të tretë	419750196
Të ardhura nga punime per vete	117,990
Të ardhura nga shitja e materialeve	31,680
Shitje te dekalruar ne FDP qe jane te ardhura ne PASH	419,899,866
Të ardhura nga interesa kreditor	347
Fitim nga kembimet valutore	73,778
Total te ardhura deklaruar ne FDP e Tatim Fitimit	419,973,991

16.Lënda e parë, shërbime dhe materiale të konsumueshme.

Materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
<i>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</i>		
Blerje materiale të para	63,747,821	109,005,514
Materialë ndihmës	250,935	487,260
	63,998,756	109,492,774
<i>Te tjera shpenzime</i>		
Blerje,energji,avull,uje	102,814	159,536
Blerje/Shpenzime mallrash, shërbimesh	85,150	
Shpenzime veshje pune	31,950	
Shpenzime punime elektrike	44,000	
Shpenzime Karburant	2,561,000	1,911,809
Blerje /Shpenzime të tjera	55,518	
Shpenzime nga punime per vete	117,990	
	2,998,422	2,071,345



17. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Pagat dhe shpërblimet e personelit	12,608,085	10,657,838
Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	2,105,149	1,779,864
	<u>14,713,234</u>	<u>12,437,702</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2020 është 43 . (2019: 26).

18. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Shpenzime konsumi dhe amortizimi detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	2,220,246	1,886,728
	<u>2,220,246</u>	<u>1,886,728</u>

19. Shpenzime te tjera shfrytezimi

Shpenzime te tjera shfrytezimi detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Nenkontraktme	195,449,950	85,952,395
Qera	1,307,476	1,398,720
Mirembajtje riparime	2,304,176	857,461
Shpenzime Transporti per blerje	123,583	336,025
Sigurime	1,018,078	894,937
Shpenzime Administrative	313,342	
Shpenzime Sherbime Noterie	325,868	
Shpenzime Konsulenca te jashtme	229,711	973,860
Shpenzime Analiza,Teste,Certifikime	180,370	
Studim ,projektim,sherbime arkitekture	766,940	
Publicitet, reklama	60,547	30,500
Shpenzime per Transferime, udhëtime, dieta	6,254,560	4,049,300
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	187,542	247,208
Shpenzime për shërbimet bankare	114,982	98,129
Taksa dhe tarifa vendore	651,600	176,405
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	141,752	
Gjoha dhe dëmshpërblime	6,981	256,438
Të tjera sherbime	783,593	692,471
	<u>210,221,050</u>	<u>95,963,849</u>



20. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit dhe shpenzime për interesa nga aktiviteti tregtar balanca e së cilave paraqitet si më poshtë: 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Fitime nga kursi i këmbimit	73,778	
Të ardhura nga interesa kreditor	347	
Shpenzime për interesa	-31,926	
Humbje nga këmbimet dhe perktimet valutore	-103,310	-6,600
	-61,111	-6,600

21. Tatimi mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
Fitimi para tatimit	125,687,046	84,861,991
Të ardhura jo tatimore		
Total shpenzime të panjohura		
Penalitet, gjoba e dëmshperblime	6,981	181,043
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	141,752	75,395
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	125,835,779	85,118,429
Tatim fitimi @15%	18,875,367	12,767,764
Rezultati i vitit	106,811,679	72,094,227

22. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Financier
Jonida Hoxhaj




Administrator
Nestor Muhametllari

